



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 19 janar 2012  
Nr. ref.: RK187/12

## AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

**Rastin nr. KI 62/11**

Parashtruesi

**Çlirim Grezda**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme, Pn. nr.  
181/2011, të datës 31 mars 2011**

### GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar  
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Ivan Čukalović, gjyqtar  
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe  
Iliriana Islami, gjyqtare

#### Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Çlirim Grezda, me vendbanim në Gjakovë.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Vendimin e Gjykatës Supreme, Pn. nr. 181/2011, të 31 marsit 2011, i cili i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 4 prill 2011.

## **Objekti i çështjes**

3. Parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimi i Gjykatës Supreme është në kundërshtim me nenet 21 [Parimet e përgjithshme], 23 [Dinjiteti i njeriut], 29 [E drejta e lirisë dhe sigurisë] dhe 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).
4. Më tej, ai pretendon se është shkelur neni 1 i Protokollit 1 të KEDNJ-së *“sepse për shkak të pamundësisë për të punuar kam mbetur pa të ardhura personale.”*
5. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) të vendosë masë të përkohshme duke urdhëruar policinë që ta tërheqë nga ueb faqja e saj njoftimin për medie në lidhje me të.

## **Baza juridike**

6. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 dhe 27 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës të datës 15 janar 2009 (Nr. 03/L-121), (në tekstin e mëtejme: “Ligji”) dhe rregullat 54, 55 dhe 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatë**

7. Më 5 maj 2011, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
8. Më 4 korrik 2011, Kryetari, me Urdhrin Nr. GJR. 62/11, e emëroi gjyqtarin Kadri Kryeziu Gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, me Urdhrin Nr. KSH. 62/11, Kryetari e emëroi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Altay Suroy (kryesues), Enver Hasani dhe Ivan Čukalović.
9. Më 9 gusht 2011, Gjykata ia komunikoi kërkesën Gjykatës Supreme dhe Prokurorit Publik të Qarkut në Pejë.
10. Më 25 nëntor 2011, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin paraprak të Gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

11. Më 16 shkurt 2011, Prokurori Publik i Qarkut në Pejë mori vendim për inicimin e procedurës hetimore ndaj parashtruesit të kërkesës dhe bashkëkryerësve të tij, me dyshimin se kishin kryer vjedhje të rëndë grabitqare nga neni 256.1 në lidhje me nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPK) (Vendimi PP-nr. 60/11 dhe PPM – nr. 12/11).
12. Më 16 shkurt 2011, Prokurori Publik paraqiti kërkesë për caktimin e masës së paraburgimit ndaj parashtruesit të kërkesës, pasi që ekzistonte dyshimi bazuar se ai kishte kryer veprën penale nga neni 256 (1) në lidhje me nenin 23 të KPK-së.

13. Më 16 shkurt 2011, Gjykata e Qarkut në Pejë ia caktoi parashtruesit të kërkesës masën e paraburgimit prej një muaj, në bazë të nenit 281 (1) të KPK-së (Vendimi PPQ. Nr. 29/11 dhe PPMQ. Nr. 10/11). Parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë kundër këtij vendimi pranë Trupit Gjykues të Gjykatës së Qarkut në Pejë.
14. Më 9 mars 2011, parashtruesi i kërkesës kërkoi që menjëherë të lirohej nga paraburgimi.
15. Më 11 mars 2011, Prokurori Publik i paraqiti kërkesë Trupit Gjykues të Gjykatës së Qarkut në Pejë që t'ia vazhdonte paraburgimin parashtruesit të kërkesës, pasi që hetimet paraprake nuk ishin përmbyllur dhe se ende kishte arsye ligjore për mbajtjen e parashtruesit të kërkesës në paraburgim.
16. Më 14 mars 2011, Gjykata e Qarkut në Pejë e hodhi poshtë si të pabazuar kërkesën e parashtruesit të datës 9 mars 2011 dhe e miratoi kërkesën e Prokurorit Publik duke ia vazhduar paraburgimin edhe për dy muaj në bazë të nenit 281 (1) të KPK (Vendimi KP. nr. 36/11). Parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë kundër këtij vendimi në Gjykatën Supreme të Kosovës.
17. Më 31 mars 2011, Gjykata Supreme e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës me arsyetimin se *“në rastin konkret ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit, po ashtu gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të qarta dhe konkrete përkitazi me bazat ligjore për të cilat iu është vazhduar paraburgimi”* (Vendimi Pn. Nr. 181/2011).
18. Më 13 prill 2011, Gjykata e Qarkut në Pejë, me kërkesë të Prokurorit Publik ia ndërpreu parashtruesit të kërkesës masën e paraburgimit dhe urdhëroi lirimin e tij të menjëhershëm, pasi që hetimet paraprake ishin ndërprerë.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

19. Parashtruesi i kërkesës pretendon se:
  - a. Nuk ekzistonte dyshimi i bazuar se ishte kryer vepra penale dhe rrjedhimisht nuk kishte arsye ligjore që Gjykata e Qarkut t'ia caktonte atij masën e paraburgimit;
  - b. Vendimi për inicimin e hetimeve nuk i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës menjëherë dhe pa vonesë, pra ai nuk ishte njoftuar për akuzat konkrete ndaj tij; dhe
  - c. I është cenuar nderi, prestigji, autoriteti dhe dinjiteti me njoftimin për shtyp të lëshuar nga Policia e Kosovës dhe me shpalljen a atij informacioni në ueb faqen e Policisë së Kosovës.

### **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

20. Parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë cenuar të drejtat e garantuara me nenet 21 [Parimet e përgjithshme], 23 [Dinjiteti i njeriut], 29 [E drejta e lirisë dhe sigurisë] dhe 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm] të Kushtetutës dhe me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] dhe nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së pasi që Gjykata Supreme, me vendimin e saj të datës 31 mars 2011, e refuzoi ankesën e tij me arsyetimin se gjykata e shkallës së parë kishte dhënë arsye të qarta në lidhje me bazën ligjore për vazhdimin e paraburgimit të parashtruesit të kërkesës.

21. Gjykata vëren se, për të gjykuar për ankesën e parashtruesit, së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
22. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk mund të ankohej se gjykatat e rregullta kanë bërë gabime të fakteve apo të ligjit përderisa nuk i kanë cenuar të drejtat dhe liritë e tij të mbrojtura me Kushtetutë.
23. Në lidhje me këtë, Gjykata Kushtetuese rithekson se nuk është gjykatë e shkallës së katërt kur shqyrton vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).
24. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat, dhe në përgjithësi procedurat në gjykatat e rregullta, të shikuara në tërësinë e tyre, janë paraqitur, respektivisht mbajtur në mënyrë të tillë ashtu që parashtruesi të ketë pasur gjykim të drejtë (shih *mutatis mutandis*, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, kërkesa Nr. 13071/87, e datës 10 korrik 1991).
25. Sa i përket këtij rasti, Gjykata vëren se Vendimi i Gjykatës Supreme, Pn. nr. 181/2011, i datës 31 mars 2011, konkludonte se *“në rastin konkret ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit, po ashtu gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të qarta dhe konkrete përkitazi me bazat ligjore për të cilat iu është vazhduar paraburgimi”*.
26. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka provuar se në çfarë mënyre vendimi i Gjykatës Supreme kanë qenë i padrejtë apo i njollosur nga arbitrariteti (shih *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituaniës, Vendimi i GJEDNJ-së në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës nr\_ 17064/06, të 30 qershorit 2009 dhe Vanek kundër Republikës Sllovaqe, Vendimi i GJEDNJ-së në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës nr. 53363/99, të 31 majit 2005), dhe se kishte paraqitur cenim të të drejtave kushtetuese në të cilat thirret parashtruesi i kërkesës.
27. Në këto rrethana, kërkesa është qartazi e pabazuar në bazë të rregullit 36 (1.c) të Rregullores së punës, i cili parashikon që: *“Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: c) kërkesa është qartazi e bazuar”*.
28. Rrjedhimisht, kërkesa e parashtruesit duhet të hedhet poshtë si e papranueshme.

### **Vlerësimi i kërkesës për masa të përkohshme**

29. Sa i përket kërkesës së parashtruesit për masa të përkohshme, Gjykata i referohet nenit 27 të Ligjit dhe, më konkretisht, rregullit 54 (1) të Rregullores së punës i cili parashikon që në çfarëdo kohe përderisa kërkesa është e pazgjidhur para Gjykatës dhe meritat e kërkesës nuk janë vendosur nga Gjykata, pala mund të kërkojë vendosjen e masës së përkohshme. Sidoqoftë, duke marrë parasysh që kërkesa u gjet si e papranueshme, parashtruesi i kërkesës në bazë të rregullit 54 (1) të Rregullores së punës nuk ka të drejtë të kërkojë masa të përkohshme.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me rregullat 36 (1.c), 54 (1) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 25 nëntor 2011, njëzëri

### VENDOSI


- I. TA REFUZOJË kërkesën për masa të përkohshme;
- II. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- III. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari raportues**



Dr. Kadri Kryeziu

**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**



Prof. dr. Enver Hasani